



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE

VLERAT STILISTIKORE
TË KOHËVE TË MËNYRËS DËFTORE
NË GJUHËN ITALIANE,
NË PËRQASJE ME SHQIPEN

PUNIM PËR GRADËN DOKTOR
NË GJUHËSI

PËRGATITUR NGA
MA. ADI MALO

UDHËHEQËS SHKENCOR
Prof. Dr. KLODETA DIBRA

T I R A N Ë: 2012

MIRËNJOHJE

Për punimin e gradës doktor në gjuhësi:

“Vlerat stilistikore te kohëve të mënyrës dëftore në gjuhën italiane, në përfaqje me shqipen”,

Falenderoj:

udhëheqësen shkencore të këtij punimi Prof. Dr. Klodeta Dibra,

familjen time për mbështetjen që më ka dhënë,

si dhe kolegët e departamentit që më janë gjendur pranë me këshillat e tyre.

FUSHA E STUDIMIT : Studimi i përket fushës së gjuhësisë dhe në një këndvështrim më të ngushtë kategorisë morfologjike të kohëve foljore. Për shkak të shtrirjes dhe natyrës së hulumtimit dhe analizës së kryer, ky studim prek edhe fusha të tjera gjuhësore, sidomos ato të semantikës, të teorive të komunikimit fjalësor, si dhe të përkthimit. Përfshin situata shprehimore që i përkasin gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar.

QËLLIMI I PUNIMIT : Qëllimi i punimit është thellimi i studimit dhe i njohjes së vlerave shprehimore dhe stilistikore të kohëve të mënyrës dëftore në ligjërim, si dhe për të pasuruar informacionin që u përcillet studentëve, në lidhje me këtë kategori gramatikore.

REZULTATET E PRITSHME TË PUNIMIT : Rezultati përfundimtar është të vërtetohet hipoteza, që më shumë se “kohën”, koha e foljeve, në situatat ligjërimore, shpreh një orientim në kohë dhe hapësirë të veprimit të dhënë nga folja, si dhe të ligjëruësve përkundrejt këtij veprimi.

METODOLOGJIA E KËRKIMIT DHE LITERATURA BAZË SHKENCORE : Metodatat që do të përdoren në këtë punim janë ato induktivo – deduktive, si dhe metoda e krahasimit, sidomos në kuadër të përqsjes së dy gjuhëve. Duke u nisur nga shëmbuj praktikë të gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, do të zbatohet metoda e analizës dhe interpretimit të nuancave semantike dhe aspekte, ndërsa më pas do të nxirren edhe përfundime me natyrë teorike. Do të bëhen përpjekje që çdo përfundim t’i nënshtrohet krahasimit, për një përfshirje sa më të gjërë të situatave shprehimore.

Literatura bazë do të jenë librat e gramatikave dhe studimet me natyrë semantike, si dhe ato aspekte më në veçanti, por pa lënë pas dore studimet në fushën e teorive interpretative të komunikimit, antologjitë e ndryshme, si dhe do të kryhet një konsultim i vazhdueshëm me fjalorë dhe enciklopedi të natyrës akademike.

KORPUSI GJUHËSOR : Përfshin gjuhësinë e përgjithshme, filozofinë e gjuhës, morfologjinë, teorinë e interpretimit të teksteve në fushat e komunikimit, si dhe teorinë e përkthimit. Do të përzgjidhen shëmbuj edhe nga gjuha e letërsisë, për të rritur dhe për fëmijë.

ZBATUESHMËRIA E KËRKIMIT : Punimi do të përpiqet të ruajë një natyrë, që situatat e marra në shqyrtim dhe përfundimet, të jenë të zbatueshme edhe nga pikpamja didaktike. Për t'u bërë sa më lehtë i kuptueshëm dhe për të ruajtur një karakter praktik, punimi do të sjellë shëmbuj të shumtë nga gjuha e përdorur në fushat ku ajo lëvrohet më tepër.